

Progres – Institutin për demokraci sociale i mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare “Olof Palme” dhe Fondacioni “Kalevi Sorsa”, në bashkëpunim me Fondacioni “Fridrih Ebert”, zyra në Maqedoni e Veriut shpallin:

KONKURS për pjesëmarrës për Akademinë Politike për demokraci sociale në vitin 2020

Akademia politike është projekt arsimor, i dizajnuar si kurs dhe trajnim akademik. Detyra kryesore e Akademisë është t'i arsimojë dhe trajnojë individët që ndajnë vlerat social-demokrate dhe në jetën e tyre të përditshme ndikojnë në formimin e vendimeve politike në Maqedoni e Veriut.

Akademia Politike do t'u ofrojë pjesëmarrësve njohuri teorike, por edhe aftësi praktike në fushën e sistemit politik, ideologjinë social-demokratike, menaxhimin politik dhe partiak dhe komunikimin politik dhe marrëdhëniet me publikun. Këto synime do të realizohen brenda katër ose pesë cikleve të seminareve tre-ditore me module nga fushat e mësipërme. Kushtet dhe afatet nuk mund të përcaktohen në këtë kohë për shkak të gjendjes së shkaktuar nga virusi COVID-19.

Kushte për pjesëmarrje

Të drejtën për të aplikuar për pjesëmarrje në Akademinë ka:

1. çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. në moshë nga 20 deri 35 vjet,
3. është i angazhuar ose dëshiron të jetë aktiv në jetën shoqërore dhe politike në Maqedoni e Veriut,
4. ndanë politikat social-demokratike, dhe vlerat ekonomike, sociale dhe shoqërore,
5. ka njohuri themelore për shkencat dhe termi-nologjinë shoqërore
6. ka njohuri të mira në gjuhën angleze

Dokumente të duhura për pjesëmarrje

1. Biografi me të dhënat për kontakt
2. Letër motivimi

Përzgjedhja e kandidatëve

Kandidatët do të përzgjidhen në bazë të arritjeve personale (përfshirë arsimin akademik, arsimin joformal, përvojën e punës dhe praktikën) të listuara në biografinë tuaj dhe në letrën motivuese, si dhe diversitetin etnik, fetar, gjinor, rajonal dhe social në Maqedoni e Veriut.

Të gjithë kandidatët e regjistruar do të njoftohen për rezultatet e përzgjedhjes, jo më vonë se 20 maj, viti 2020 me anë të postës elektronike. Me disa nga kandidatët e zgjedhur, mund të ketë nevojë për të zbatuar një intervistë. Dokumentet jo të plota nuk do të merren parasysh!

Dorëzimi i dokumenteve

Dokumentet për paraqitje duhet të dërgohen jo më vonë se 11 maj, viti 2020 në postën elektronike: pa@progres.org.mk

